



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Nr _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2020

SQARIME MBI DOKUMENTET E GARËS

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pas kërkesës së disa operatorëve ekonomikë mbi sqarime për dokumentet e procedurës së koncesionit/ partneritetit publik privat, me objekt “Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit të Vlorës” me Nr. Reference REF-46571-12-19-2019, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, sqaron operatorët ekonomikë në lidhje me kërkesat e tyre si edhe pa identifikuar burimin e kërkesës, ia komunikon sqarimin përkatës të gjithë operatorëve të tjerë ekonomikë të interesuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nxit të gjithë operatorët ekonomikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të interesuar për të paraqitur çdo kërkesë për sqarim e cila lidhet me aspektet teknike të procedurës së koncesionit, në kompetencë të trajtimit nga kjo e fundit si edhe të cilat nuk lidhen me kuadrin ligjor në përgjithësi dhe/ ose raste të cilat qartësisht dhe pa ekuivok janë pasqyruar në dokumentet e garës koncesionare.

PYETJE

1. Vlera e tarifës që duhet të paguajë operatori ekonomik në rast të ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik është 10% e vlerës së Sigurisë së Ofertave. Ne kërkojmë nga ju që të

sqaroni natyrën e kësaj ankese. A është ky një objekt në dispozicion të koncesionarit dhe nëse po, çfarë ankesash mund të ngrihen lidhur me këtë?

PËRGJIGJE

Sqarojmë se bëhet fjalë për ankesat në kuadër të rishikimit administrativ në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar. Referuar ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat operatorët ekonomikë mund të paraqesin ankesë për dokumentet e procedurës konkurruese, (afat procedural i cili ka përfunduar në datën 30.12.2019) si edhe kundër vendimit të vlerësimit/klasifikimit përfundimtar (afat procedural i cili nis në përputhje me nenin 43 të ligjit pas vlerësimit të komisionit të dhënies së koncesionit). Ankesa paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik në përputhje me sa më sipër cituar si edhe të Vendimit nr.401 datë 13.05.2015 “Për përcaktimin e tarifës dhe rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimi ndaj procedurave të koncesionit/ partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”.

PYETJE

2. Vlera e tarifës ATRAKO, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" të ndryshuar, është shuma që duhet të paguhet nga Koncesionari Fitues për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesionit (ATRAKO). Ne kërkojmë një sqarim se cila është vlera e tarifës së ATRAKO që duhet të paguhet nga Koncesionari fitues.

PËRGJIGJE

Ju sqarojmë se në përputhje me legjislacionin në fuqi, shuma e pagueshme e cila paguhet nga koncesionari për shërbimet e ATRAKO, për projektet koncesionare me vlerë mbi 50,000,000 Euro është 30,000 Euro. Kjo shumë paguhet vetëm një herë.

PYETJE

3. Në rast se tejkalohe të ardhurat e parashikuara, në rastin optimal, atëherë të ardhurat e parashikuara do të ndahen me shtetin në raportin 50:50.

A nënkupton kjo që nëse të ardhurat nga koncesioni tejkalojnë të ardhurat minimale të garantuara në rastin optimal, të ardhurat minimale të garantuara do të ndahen 50:50 ndërmjet autoritetit dhe koncesionarit dhe teprica do t'i kalojë koncesionarit?

Ne dëshirojmë të vëmë në dukje që kjo do të rezultojë në kthim më të ulët për koncesionarin në rast se ai është në gjendje të maksimizojë të ardhurat. Ju lutemi jepni një shpjegim lidhur me këtë

PËRGJIGJE

Niveli minimal i të ardhurave përllëgaritet duke përdorur skenarin bazë (ju lutemi shihni tabelën 14 – Parashikimi i Trafikut, në faqen 44 të Studimit të Fizibilitetit) të të ardhurave të gjeneruara (nga shërbimet e avionit dhe shërbimet e tjera tregëtare). Nëse të ardhurat tejkalojnë rastin optimist atëherë shuma që tejkalon parashikimin do të ndahet në raport 50:50 me Qeverinë shqiptare.

Sqarojmë se kërkesa e mësipërme është kriter i panegociueshëm.

Në lidhje me pikën e dytë, pretendimi i mësipërm nuk lidhet me kërkesë për sqarime të dokumenteve të garës, por me ankim në lidhje me kriteret e kualifikimit/vlerësimit. Sqarojmë se procedura e rishikimit administrativ rregullohet nga neni 43 i ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

PYETJE

4. Lidhja e aeroportit me Autostradën Fier-Vlorë. Do të donim një sqarim për sa i përket afateve të pritura për përfundimin e rrugës hyrëse të nevojshme.

PËRGJIGJE

Sqarojmë se përveç infrastrukturës në aeroport, është shumë e rëndësishme që të ketë një lidhje të mirë rrugore midis qytetit, autostradës dhe aeroportit për të siguruar që udhëtarët do të vijnë në kohë në aeroport nga njëra anë dhe nga ana tjetër për të rritur zonën e mbulimit të aeroportit. Aktualisht rreth 2 kilometra nga aeroporti ndodhet autostrada rrugore Fier – Vlore. Kjo autostradë ka hapësirë për lidhje me rrugën e aeroportit të ri.

Ky është një investim i cili do të merret përsipër nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe përfundimi i rrugës do të jetë gati para nisjes së operimit të aeroportit.

PYETJE

5. Një operator ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë. Me këtë kuptojmë që një ofertues/pjesëtar i një konsorciumi lejohet të paraqesë vetëm një ofertë.
Ju lutem na e konfirmoni këtë.

PËRGJIGJE

Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën procedurë Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

PYETJE

6. A mund të sqaroni nëse banka që lëshon sigurimin e ofertës duhet medoemos të jetë një bankë shqiptare apo mund të pranohet gjithashtu dhe garancia nga një bankë e vendit nga i cili vjen ofertuesi?

PËRGJIGJE

Autoriteti kontraktues sqaron se sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar dhe që ushtron aktivitetin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Pranohen rastet e lëshimit të sigurimit të ofertës nga banka të cilat ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

PYETJE

7. Në rast të shpalljes së fituesit, Ofertuesi do të refuzojë pagimin e shpenzimeve sipas paragrafit 1.4 të Dokumenteve Standarde të Procedurës Konkurruese. A është e mundur që të na informoni rreth Dokumenteve Standarde të Procedurës Konkurruese dhe të cilësoni pagesën e shpenzimeve të referuar këtu?

PËRGJIGJE

Lutem, sqarojmë se referenca përkatëse është paragrafi 1.5 i Dokumenteve Standarde të Procedurës Konkurruese.

PYETJE

8. Përvoja e kontraktimit - ndërtimi. Rinovimi i dhjetë (10) pistave në dhjetë (10) vitet e fundit. Rinovimi i 10 pistave është një kërkesë shumë e rreptë pasi objekti i këtij projekti ka të bëjë vetëm ndërtimin e një pistë të vetme.

Dëshirojmë të vëmë në dukje që për një projekt të kësaj madhësie, përvoja e ndërtimit të një pistë të vetme me specifikimet e kërkuara duhet të konsiderohet si përvojë e pranueshme. Projektet globale të viteve të fundit për aeroportet (të tilla si ato në Evropën Jug-Lindore, p.sh. Beogradi, Sofja, Mali i Zi) kanë përfshirë gjithashtu kërkesa proporcionale bazuar në kapacitetin / infrastrukturën ekzistuese dhe atë të planifikuar.

PËRGJIGJE

Pretendimi i mësipërm nuk lidhet me kërkesë për sqarime të dokumenteve të garës, por me ankim në lidhje me kriteret e kualifikimit/vlerësimit. Sqarojmë se procedura e rishikimit administrativ rregullohet nga neni 43 i ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar

PYETJE

9. Përvoja e kontraktimit – ndërtim. Rinovimi / zgjerimi i dhjetë (10) terminaleve në dhjetë (10) vitet e fundit. Rinovimi i 10 terminaleve është një kërkesë shumë e rreptë pasi objekti i këtij projekti lidhet vetëm me ndërtimin e një terminali të vetëm. Dëshirojmë të vëmë në dukje që për një projekt të përmasave të tilla, përvoja e ndërtimit të një terminali të vetëm ose 2-3 terminaleve me sipërfaqen dhe specifikimet e kërkuara duhet të konsiderohet si përvojë e pranueshme. Projektet globale të aeroportit në të kaluarën e afërt (të tilla si ato në Evropën Jug-Lindore, p.sh. Beogradi, Sofja, Mali i Zi) kanë përfshirë gjithashtu kërkesa proporcionale bazuar në kapacitetin / infrastrukturën ekzistuese dhe atë të planifikuar.

PËRGJIGJE

Pretendimi i mësipërm nuk lidhet me kërkesë për sqarime të dokumenteve të garës, por me ankim në lidhje me kriteret e kualifikimit/vlerësimit. Sqarojmë se procedura e

rishikimit administrativ rregullohet nga neni 43 i ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

PYETJE

10. Përvoja në Sistemin ose Rrjetin e Aeroporteve: Ofertuesit duhet të sigurojnë prova të ekspertizës së tyre të certifikuar lidhur me menaxhimin e sistemeve të aeroportit (duke përfshirë dhe kompetencat për trafikun). Kërkojmë nga ju që të sqaroni se çfarë nënkupton një rrjet aeroportesh në këtë rast. Gjithashtu, cilat janë provat që duhet të paraqesim për të vërtetuar ekspertizën në menaxhimin e sistemeve të aeroportit?

PËRGJIGJE

Autoriteti kontraktues sqaron se në dokumentet e garës shprehet qartësisht për nivelin e certifikimi të kërkuar dhe mënyrës së përmbushjes së kriterit, i cili nuk kufizohet vetëm në këto rregullore por nga të gjithë rregulloret e ICAO, KE, EASA.

PYETJE

11. “Shoqëri Filial”, nënkupton çdo shoqëri që ka kontrollin e asaj shoqërie, çdo shoqëri që është nën kontrollin e asaj shoqërie, ose ndonjë shoqëri vartëse që ka kontrollin e asaj shoqërie. Ju lutemi sqaroni se si përcaktohet kontrolli sipas kësaj kontrate. Për shembull, për sa i përket përqindjes së aksioneve (më shumë se 50%), kontrollit të marrjes së vendimeve etj.

PËRGJIGJE

I njëjti kuptim i dhënë edhe në Seksionin “Përkufizimet e termave” të draft kontratës koncesionare ku sqarohet se: *“Shoqëri e Lidhur”, ka kuptimin e çdo shoqërie që zotëron Kontrollin e asaj shoqërie, çdo shoqëri që është nën Kontrollin e asaj shoqërie, ose çdo shoqëri e varur, e cila ka Kontrollin mbi atë shoqëri. Çdo shoqëri e llojit holding (që zotëron Aksionet/Kuotat e shoqërive të tjera) që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare, çdo shoqëri tregtare mbi të cilën ushtrohet kontroll, çdo shoqëri e kontrolluar direkt ose indirekt nga i njëjti holding, ose çdo shoqëri e kontrolluar e një shoqërie te llojit holding që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare”*

PYETJE

12. Në draft kontratë janë lënë bosh afatet kohore në shumicën e klauzolave. Afatet e përcaktuara janë të nevojshme për këto klauzola, pasi ato mbulojnë aspekte thelbësore të përmbushjes së kontratës. A mund të bëni një sqarim lidhur me këtë?

PËRGJIGJE

Kontrata përfundimtare do të jetë subjekt i negociimit midis ofertuesit të shpallur fitues dhe autoritetit kontraktues. Afatet e lëna bosh do të plotësohen në përputhje me ofertën teknike të ofertuesit dhe negociatave mes palëve.

PYETJE

13. Pas nënshkrimit të Kontratës, lëshohet garanci nga një shoqëri e sigurimeve në shumën prej ...% të vlerës së Punimeve të Ndërtimit. Ju lutemi sqaroni se në cilën vlerë duhet të jetë garancia që do të dorëzohet gjatë periudhës së ndërtimit të aeroportit? Klauzola përcakton se një garanci e vlefshme është ajo e lëshuar nga një shoqëri sigurimi. Sipas kësaj klauzolë, a do të pranohet garancia e lëshuar nga një bankë?

PËRGJIGJE

Kontrata përfundimtare do të jetë subjekt i negociimit midis ofertuesit të shpallur fitues dhe autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues sqaron se referuar nenit 28 të ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i ndryshuar parashikohet se: *“Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.). Sigurimi i kontratës do të jetë deri në 5 % të vlerës së kontratës dhe përcaktohet në dokumentet e tenderit.”*

Sigurimi i kontratës do të jetë në masën 5 % të vlerës së kontratës, si maksimum i garancisë ligjore të kërkuar.

Në objekt të negocimit të kontratës do të përcaktohet nëse sigurimi i kontratës do të pranohet lëshuar nga bankë ose shoqëri sigurimesh.

PYETJE

14. (Shtatë) ditë pune para datës së fillimit të zbatimit të kontratës dhe deri në përfundimin e punimeve, lëshohet një garanci nga një bankë e nivelit të dytë ose shoqëri sigurimesh. Klauzola përmend një garanci të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, por nuk përcakton askund se çfarë do të thotë nga një bankë e nivelit të dytë. Ju lutemi sqaroni se çfarë nënkupton një bankë e nivelit të dytë.

PËRGJIGJE

Bankë e nivelit të dytë ka kuptimin e çdo banke tregtare që ushtron veprimtari bankare për individë dhe/ose subjekte juridike në përputhje me legjislacionin kombëtar, e ndryshme nga Banka Qendrore (e nivelit të parë) e cila luan rol rregullator.

PYETJE

15. Nëse të ardhurat e projektit tejkalojnë nivelin e të ardhurave të parashikuara në skenarin bazë, atëherë kjo shumë do të ndahet ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në raportin 50:50, në përputhje me Shtojcën 18 të kësaj kontrate. Këtu përcaktohet që nëse të ardhurat tejkalojnë nivelin e parashikuar në skenarin fillestar, ndarja 50:50 do të jetë e zbatueshme por formulimi në RFP e cilëson ndarjen 50:50 si të zbatueshme nëse të ardhurat tejkalojnë parashikimet e rastit optimist. Ju lutemi sqaroni se cili rast është i zbatueshëm?

PËRGJIGJE

Kontrata përfundimtare do të jetë subjekt i negociimit midis ofertuesit të shpallur fitues dhe autoritetit kontraktues. Ju lutemi për bazë referohuni vetëm dokumenteve të procedurës konkurruese ku parashikohet se: “Në rast të tejkalimit të të ardhurave të parashikuara në rastin optimist, atëherë të ardhurat mbi nivelin e parashikuar do të ndahen në raport 50:50 me shtetin”

PYETJE

16. Shoqëria do të paguajë ndaj Autoritetit Kontraktues një tarifë në shumën të fitimeve të shpërndara pas vitit të të funksionimit për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Kontrate, çdo vit. Ju lutemi sqaroni nëse pagesa e tarifës së koncesionit përllongaritet si përqindje e fitimeve apo e të ardhurave vjetore? Cila do të jetë shumja e të ardhurave mbi të cilat do të aplikohet pagesa e tarifës së koncesionit, pasi është lënë e paplotësuar?

PËRGJIGJE

Kontrata përfundimtare do të jetë subjekt i negociimit midis ofertuesit të shpallur fitues dhe autoritetit kontraktues.

Sqarojmë se në shtojcën 11 “Kriteret e Vlerësimit” të dokumenteve të garës shprehet qartësisht në lidhje me tarifën koncesionare.

Tarifa koncesionare përllongaritet si përqindje e të ardhurave totale vjetore. Çështjet e lehtësirave fiskale mbi të ardhurat do të përcaktohen gjatë fazës së negociimit (nëse aplikohet).

17. PYETJE

Kostot dhe shpenzimet e dorëzimit të Territorit të Projektit dhe dhënies së të drejtave të koncesionarit do të mbulohen nga Koncesionari. Për cilat kosto dhe shpenzime të dorëzimit të Territorit të Projektit bëhet fjalë në këtë pikë? Meqenëse të gjitha shpenzimet në lidhje me shpronësimet përmenden si një Shkak Zbutjeje dhe / ose Shkak Kompensimi, ju lutemi përcaktoni se cilat shpenzime specifike janë të zbatueshme për Koncesionarin.

PËRGJIGJE

Toka është në pronësi shtetërore miratuar me Vendimin nr. 813 datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek MIE të pronës nr. 914 me emërtim “Aerodrom Fushor”, me vendndodhjen në Vlorë, dhe për një ndryshim në VKM 515 datë 18.7.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kalojnë në përgjegjësi administrimit Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar” dhe si e tillë asnjë shpronësim nuk është i aplikueshëm.

Kontrata përfundimtare do të jetë subjekt i negociimit midis ofertuesit të shpallur fitues dhe autoritetit kontraktues.

Kostot e tjera përfshijnë të gjithë detyrimet tarifare ligjore për vënien në zbatim të projektit (leje, licenca, autorizime, etj)

Çdo sqarim i bërë sa më sipër është i bazuar në ligjin 125/ 2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe dokumenteve të procedurës konkurruese.

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT